



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:367929

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06788495

**2024:367930**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit I.Q., për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.2068/24, të dt. 24.12.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 27.01.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës sipas detyrës zyrtare av. Arbër Jashari dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29.01.2025, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri I.Q., nga i ati I., e ëma S., e vajzërisë G. , i lindur më datën ...., në ...., Komuna .... ku edhe jeton, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ndërtimtari, i martuar baba i 3 fëmijëve i gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e papërcaktuar deri me datë 11 Dhjetor 2024 në fshatin ....., Komuna ....., i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët në Kosovë, ka mbajtur pa leje valide në pronësi, kontroll dhe posedim armën e gjuetisë e markës “....”, me numër serik .... prodhim Italian, së bashku me pesë copë fishekë, ndërsa me rastin e kontrollit të kryer nga ana e Policisë së Kosovës, të njëjtit i gjendet dhe i sekuestrohet.

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe neni 366 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe neneve 364 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

## **G J Y K O N**

Me Dënim me gjobë në lartësi prej 300 /treqindë euro/, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën atëherë konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-se, gjykata do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 €/ njëzet euro/ të pa paguara, do e vuaj një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në kuptim të nenit 366 par. 3 të KPRK-së, i konfiskohet në mënyrë të përhershme arma e gjuetisë e markës “....”, me numër serik .... prodhim Italian.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 2068/24, të dt. 24.12.2024, ka ngarkuar të pandehurit për shkak të kryerjes së veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 27.01.2025, në të cilën seancë kane prezantuar prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza, për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare pas konsultimit me mbrojtësin tim, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, e di që kam gabuar dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepra penale apo vepra tjera penale, dua të shtoj se armen e gjuetisë e kam pasur me leje më parë, sipas Shoqatës së Gjuetareve në Shtime dhe atë të Ferizaj, si dëshmi posedoj lejet të lëshuara nga këto shoqata, e cila leje ka skaduar me datën 26.03.2024

dhe kam harruar që të bëj kërkesë për vazhdimin e saj, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin pasi që nuk jam person që shkaktoj probleme.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit I.Q., pasi që ky pranim është bërë konform nenit 242 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare duke u mbështetur në prova dhe fakte që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj, përkritazi për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, po ashtu i njëjti nuk është i njohur për organet e ndjekjes sipas evidencës, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, pendimi i tij i thellë, si dhe në bazë të rrethanave i njëjti në momentin e sigurimit të armës është pajisur me leje, por që në momentin e skadimit të afatit i njëjti nuk ka aplikuar tutje për vazhdimin e lejes për arme, po ashtu i propozoj gjykatës që konform nenit 366 par 3 të KPPRK-së, të bëj konfiskimin e armës.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaron se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim dhe vlerësojmë se ky pranim i fajësisë është bërë pasi që të njëjtit i janë sqaruar pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës, vlerësojmë se kjo është në përputhje me dispozitat ligjore, i propozojmë gjykatës që të aprovoj si të tillë, gjithashtu sa i përket armës së konfiskuar duke qenë se i njëjti të njëjtën e ka pasur me leje me afat prej 5 viteve dhe i njëjti ka qenë në lajthitje lidhur me afatshmerinë e saj, i propozojmë gjykatës që e njëjta armë të pandehurit të i kthehet. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozojmë gjykatës që si rrethane lehtësuese të merr parasysht faktin se i njëjti është prind i 3 fëmijëve, i njëjti nuk ka qenë kryerës i ndonjë vepre penale më parë.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti fillestar i incidentit, i datës

11.12.2024, Vërtetimi mbi konfiskimin e armatimit dhe municionit i datës 11.12.2024, Raporti i oficerit, i datës 11.12.2024, Fotografitë, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *( nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së,, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale, për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e singertë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit veprë të tillë apo të ngjashme, se nuk ka dëshmi se më parë të jetë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë së sajë dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen ( preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskim, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 366 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,  
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
2024:367930, datë 29.01.2025**

**Zyrtare ligjore  
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.